



Fletë informative për azilkërkues

Ju jeni arratisur dhe kërkoni mbrojtje në Zvicër? Ndiurma Zvicerane për Refugjatë SFH ka krijuar këtë fletë informative. Ajo ju shpjegon etapat më të rëndësishme në procedurën e azilit.

SFH-ja është një organizatë joqeveritare e cila angazhohet për të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve. Faqen tonë të internetit e gjeni në adresën vijuese: www.osar.ch; informata për azilkërkues dhe refugjatë në shumë gjuhë i gjeni edhe këtu: www.for-refugees.ch

1. Dorëzimi i kërkesës së azilit

1.1 Qendra e pritjes dhe procedurës

Kërkesën tuaj të azilit duhet ta dorëzoni në njërin prej qendrave të pritjes të Entit Federal për Migracion BFM. Ka qendra të tilla në **Basel, Chiasso, Vallorbe dhe Kreuzlingen**.

- Gjatë gjithë kohës së procedurës (eventualisht vetëm në fillim) banoni në qendrën e pritjes.
- Duhet të dorëzoni dokumentet tuaja të identitetit dhe të udhëtimit. Do të merreni në pyetje.
- Në rast se e keni dorëzuar kërkesën tuaj në aeroport, së paku në fillim banoni në terrenin e aeroportit.
- Pasi bëtë kërkesë për azil, regjistrohëni, fotoqohëni dhe merreni gjurmët e gishtërinjve tuaj. Autoritetet Zvicerane pastaj do pyesin se mos gjurmët e gishtërinjve tuaj tashmë gjinden të regjistruar në bazën qendrore të dhënave (Eurodac) nga ndonjë shtet tjetër i Bashkimit Evropian, Norvegji apo Islandë. Nëse këto raste pohohen, ky shtet tjetër evropian do duhej të jetë përgjegjës për trajtimin e çështjes së juaj të azilit, përveç nëse bashkëshorti/ja apo fëmijët e juaj gjinden në Zvicër. Atëherë, Zvicra do të tentoj të ju shpërngul në këtë shtet kompetent evropian. Ju keni të drejtë të shtroni kërkesën për azil vetëm një herë në njërin prej shteteve evropiane (dekreti i Dublinit). Dhe vetëm shteti i parë do duhej ta marr përsipër dhe ta shqyrton në mënyrë korrekte kërkesën e juaj të azilit. Nëse ju tashmë ndonjëherë keni kërkuar azil në ndonjë shtet tjetër evropian, mirëpo jeni të mendimit se ky shtet i parë nuk e ka trajtuar korrekt procedurën e juaj të azilit, atëherë ju patjetër duhet të kërkoni një përfaqësim ligjor apo qendër për këshillime ligjore pranë qendrave pranuese dhe procedurale të azilit. Kërkoni për të qëndruar në Zvicër nëse për shembull keni frikë që shteti evropian në të cilin Zvicra dëshiron të ju dërgon, do të ju dëbon drejtë për së drejti në vendlindjen e juaj pa e shqyrtuar mirë kërkesën e juaj të azilit ndonjëherë ju e plotësoni besueshmërinë e statusit të refugjatëve.

Gjithashtu kërkoni për të qëndruar në Zvicër, nëse për shembull keni frikë se Zvicra do të ju dërgon në një shtet evropian i cili pastaj mund të ju dëboj për në vendlindje ku ju kanoset rreziku nga torturat apo dënimet degraduese dhe jo njerëzore.

1.2 Regjistrimi

Autoritetet **ju bëjnë pyetje** për **identitetin** tuaj dhe për identitetin e familjes suaj, për **rrugën tuaj të udhëtimit** dhe për **arsyet e arratisë suaj**. Në këtë intervistë janë prezentë një nëpunës ose nëpunëse shteti dhe në rast nevoje një përkthyes ose një përkthyes.

- Jepni të gjitha arsyet e rëndësishme përse keni ikur nga vendlindja juaj.
- Në qoftë se keni përjetuar ndonjë gjë për të cilën nuk mund të flisni para një burri ose para një gruaje, thuajeni.
- Shpjegoni arsyet në qoftë se nuk mund të dorëzoni dokumente identiteti.
- Thuajeni nëse ka diçka që nuk keni kuptuar.

Në fund të çdo interviste duhet të nënshkruani një protokoll. Verifikoni mirë nëse përgjigjet tuaja janë shënuar në mënyrë të saktë dhe nëse u shkrua gjithçka që keni thënë.



1.3 Dokumentet / provat

- Dokumentet që dëshmojnë situatën tuaj të përndjekjes jepini për t'u vendosur në dosje.
- Mbani fotokopje e të gjitha dokumenteve që dorëzoni.

1.4 Sqarimet

Eventualisht kryhen sqarime të mëtejshme në rastin tuaj.

- Në rast se ka dyshime lidhur me prejardhjen tuaj, mund të merreni në pyetje nga një njohës të gjuhëve dhe mund të kontrollohen njohuritë tuaja për vendin e prejardhjes suaj.
- Në rast se ka dyshime lidhur me moshën tuaj, mund të hartohet një ekspertizë.

1.5 Si do të vazhdojë?

Procedura e azilit nuk është njëloj për të gjithë; ka mundësi të ndryshme, për shembull:

- Ju merrni një vendim menjëherë në qendrën e pritjes.
- Në qendrën e pritjes merreni edhe një herë në pyetje në mënyrë të hollësishme për arsyet tuaja të azilit.
- Juve ju caktohet një kanton dhe ju strehoheni në një qendër për azilkërkues (transferim).
- Vetëm pas transferimit merreni edhe një herë në pyetje për arsyet tuaja të arratisë.
- Vetëm pas transferimit do të merrni një vendim të azilit.
- Ju merrni një letërnjoftim N (letërnjoftim për azilkërkues).



2. Intervista

Intervistat në procedurën e azilit **janë shumë të rëndësishme**. Mund të intervistoheni një herë ose disa herë. Autoritetet gjykojnë kërkesën tuaj të azilit të mbështetur mbi intervistat si dhe mbi protokollet e këtyre intervistave.

2.1 Kush merr pjesë në intervistat?

- Një **nëpunës shteti** ose një **nëpunëse shteti** e udhëheq intervistën.
- Një **përkthyes** ose një **përkthyes** duhet të bëjë një përkthim të plotë, shpjegimet tuaja nuk duhet të vlerësohen ose të përfshihen. Personi mund të mbetet anonim. Ju mund të shoqëroheni nga një përkthyes të cilin e zgjidhni ju, por ai vetë nuk duhet të jetë azilkërkues.
- Një **përfaqësues i një shoqate humanitare** (person që i përket një organizate joqeveritare) e vëzhgon procedurën. Ky person mund të kërkojë që të shtrohen pyetje të mëtejshme dhe do t'i dërgojë shoqatës së tij humanitare një raport për intervistën.
- Ju mund të shoqëroheni nga një **përfaqësues ligjor** të marrë në detyrë nga ju, ose nga ndonjë person madhor (ai vetë nuk duhet të ketë një kërkesë të papërfunduar).

2.2 Pyetjet

Në përgjithësi, rrjedha e një interviste është si vijon:

Pas prezantimit të të gjithë të pranishmëve, juve ju shpjegohet rrjedha e intervistës si dhe të drejtat dhe detyrat tuaja, pastaj nëpunësi ose nëpunësja e shtetit ju bën **pyetje për situatën tuaj personale**:

- për identitetin tuaj dhe për dokumente që dëshmojnë identitetin tuaj
- për familjen dhe të afërmit tuaj
- për shërbimin ushtarak
- për rrugën e udhëtimit nga vendi i nisjes deri në Zvicër
- për punësim në vendlindje dhe në Zvicër
- për qëndrime jashtë vendit tuaj
- për përfaqësimin ligjor në vendlindje dhe në Zvicër

Pas kësaj keni mundësi për të shpjeguar përse kërkon mbrojtje në Zvicër.

Sipas ligjit (neni 3 i Ligjit të Azilit), refugjatëve i jepet azil.

Refugjatë janë persona të cilët u janë nënshtruar disavantazheve serioze në vendlindjen e tyre ose në vendin në të cilin kanë banuar së fundi, për shkak të racës, fesë, kombësisë së tyre, përkatësisë së një grupi të përcaktuar shoqëror ose për shkak të bindjeve të tyre politike, ose që kanë frikë të arsyetuar t'u nënshtrohen disavantazheve të tilla. Si disavantazhe serioze konsiderohen veçanërisht rrezikimi i shëndetit, i jetës ose i lirisë si dhe masa që shkaktojnë një shtypje të padurueshme psikike.

Duhet të merren parasysh arsyet e arratisë që janë specifike për femrat.

2.3 Kërkimi i mbrojtjes në Zvicër

Gjatë intervistës duhet të përshkruani të gjitha arsyet përse jeni arratisur dhe dëshironi të merrni azil. Ju mund të flisni lirisht dhe pa frikë. Të gjithë të pranishmit i nënshtrohen një detyrimi të mbajtjes së fshehtësisë dhe nuk duhet t'i tregojnë askujt atë që thoni.


Kjo pjesë e intervistës është shumë e rëndësishme. Ju luteni **të tregoni se çfarë ose kush ju ka shtyrë ta braktisni vendlindjen tuaj.**

- Përgjigjja juaj duhet të jetë e vërtetë. Tregoni sa më shumë hollësi.
- Bisedoni edhe për ndjenja, thuajeni nëse keni përjetuar ndonjë gjë për të cilën nuk mund të flisni para një burri ose para një gruaje.
- Sillni me vetë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me përndjekjen tuaj (thirrje në polici, gjykime, dokumente burgu, letra kërcënuese, dëshmi mjekësore, gazeta, fotografi etj. - mbani kopje me vetë!).
- Nëse tashmë keni qenë në ndonjë shtet tjetër evropian dhe keni frikë se ky shtet do të ju dëbojë në vendlindjen tuaj ku ju kanoset rreziku nga torturat apo dënimet degraduese dhe jo njerëzore, e thuani këtë dhe e shtjelloni hollësisht frikën dhe shqetësimet e juaja.

Ndoshta ju shtrohen pyetje të mëtejshme për **paqartësi, keqkuptime dhe kundërshtime**. Pohimet tuaja për këto duhet të shënohen dhe t'ju përkthehen juve.

2.4 Intervista e familjeve

Anëtarët e familjes merren në pyetje **veçmas**. Kur intervistohet një anëtar madhor i familjes, të tjerët duhet të presin në një dhomë tjetër. Po qe se nuk ka arsye kundër kësaj, fëmijët duhet të intervistohen në prani të prindërve të tyre.



3. Protokoll

Për çdo intervistë bëhet një protokoll. Pas çdo interviste ju përkthehet protokoll. Ju luteni të nënshkruani çdo faqe.

→ Thuajeni nëse ka diçka që nuk keni kuptuar. Verifikoni nëse protokollin përputhet saktësisht me atë që donit të thoshit. Kërkoni që të korrigjohen gabimet dhe paqartësitë.

Në fund të intervistës pyeteni se a keni edhe arsye të tjera, të papërmendura deri më tani, për qëndrimin në Zvicër. Duhet të konfirmoni me nënshkrimin tuaj se keni thënë gjithçka dhe që protokollin përputhet me të vërtetën.

4. Vendimet e azilit

Procedurat e azilit në Zvicër zgjasin nganjëherë vetëm **disa ditë ose javë**. Kontaktoni me kohë qendrat e këshillimit ([lista e adresave](#))!


Zakonisht merrni nga **Enti Federal për Migracion** një vendim me shkrim në gjermanisht, frëngjisht ose italisht. Ka shumë lloje të ndryshme të vendimit të azilit:

4.1 Azili

Azilkërkuesve që njihen si refugjatë, u jepet zakonisht azil. Kush ka azil, merr një **miratim B** dhe letërnjoftimin e refugjatit dhe mund të marrë më pas bashkëshorten/-in dhe fëmijët e mitur në Zvicër. Pesë vite pas hyrjes, refugjatët marrin një **letërnjoftim C**.

4.2 Pranimi i përkohshëm

Eventualisht refuzohet kërkesa juaj për azil, por me një **miratim F** mund të qëndroni megjithatë në Zvicër. Ky është rasti nëse dëbimi në vendlindjen tuaj *nuk është i mundur* ose për shkak të rreziqeve të mëdha *nuk është i kërkueshëm*. Për shembull në gjendje lufte civile ose sëmundjeje të rëndë. Miratimi tërhiqet kur gjendja përmirësohet.



4.3 Vendimet negative

Vendimi negativ i azilit dhe vendimi i dëbimit me arsyetim

Kërkesa e azilit refuzohet, dhe ju duhet të ikni nga Zvicra në fund të një afati largimi. Kjo është e mundur në qoftë se – sipas mendimit të autoriteteve – nuk keni arsye të mjaftueshme për arrati ose në qoftë se nuk mund ta tregoni ose provoni historinë tuaj në mënyrë mjaft të besueshme.

Vendimi pa arsyetim

(Vendimi i mosdodhjes, dëbimi në një vend tjetër apo dëbimi në një vend prej shteteve të Bashkimit Evropian, Islandë apo Norvegji)

Kërkesa juaj, pas intervistës së parë të shkurtër, nuk trajtohet më tej, dhe ju duhet të largoheni menjëherë nga Zvicra. Kjo është e mundur:

- Në qoftë se para hyrjes në Zvicër keni qenë në ndonjë vend prej shteteve të Bashkimit Evropian, në Islandë apo Norvegji, juve do të ju pyesin shkurtimisht për mënyrën e udhëtimit dhe në këtë intervistë nuk do të jetë prezent asnjë përfaqësues i organizatave ndihmuese. Në rast të tillë, ju do të ktheheni në këtë shtet i cili është përgjegjës për procedurat e zbatimit si dhe dëbimit të çështjes së juaj të azilit.
- Në qoftë se para hyrjes në Zvicër keni qëndruar ose jetuar për një kohë të gjatë në një vend tjetër ose nëse atje banojnë të afërmit tuaj.
- Në qoftë se keni bërë më parë kërkesë për azil në Zvicër ose në një vend tjetër evropian dhe nuk mund të parashtroni arsye të reja për azil
- Në qoftë se nuk kërkonti mbrojtje në Zvicër, por keni ardhur për arsye të tjera (probleme familjare ose ekonomike).
- Në qoftë se keni fshehur identitetin tuaj të vërtetë (emri i gabuar, datëlindja e gabuar etj.).
- Në qoftë se shkelni detyrën tuaj për bashkëpunim me autoritetet zvicerane (për shembull duke mos ardhur në intervistë).
- Në qoftë se nuk keni dokumente identiteti, nuk mund të gjeni dokumente brenda 48 orësh, nuk keni shfaqur bindës për këtë dhe arsye të arratisë suaj u duken autoriteteve krejt të pabesueshme.
- Në qoftë se vini nga një shtet i cili autoritetet zvicerane e konsiderojnë si të sigurt nga përndjekja dhe arsye të arratisë suaj u duken autoriteteve të pabesueshme (Safe Country).
- Në qoftë se keni qëndruar ilegalisht në Zvicër, keni dorëzuar një kërkesë për azil vetëm pas një arrestimi dhe arsye të arratisë suaj u duken autoriteteve krejt të pabesueshme.

Kujdes: Në qoftë se nuk dorëzoni asnjë ankesë, si dhe pas refuzimit të ankesës, ndodheni ilegalisht në Zvicër.

Në varësi të arsyes së refuzimit mund të arrestoheni menjëherë pas marrjes së vendimit.


Por në qoftë se dorëzoni një ankesë, zakonisht juve ju lejohe të qëndroni në Zvicër përderisa të vendoset për të.

Keni kujdes, ekziston një **përjashtim**: Nëse më parë keni qenë në ndonjë shtet të Bashkimit Evropian dhe ky shtet është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së juaj të azilit, ju prapë se prapë mund të kërkonti nga autoritetet zvicerane për të qëndruar në Zvicër dhe për të pritur vendimin e ankesës së juaj. Por këtë ju duhet ta arsyetoni duke dhënë të dhëna të hollësishme sa i përket rastit të juaj ekzistues. Kërkonti për të qëndruar në Zvicër, nëse për shembull keni arsye se ky shtet evropian:

- do të ju dërgon drejtë për së drejti në vendlindjen e juaj, ku juve ju kanoset rreziku nga torturat apo dënimet degraduese dhe jo njerëzore.
- do të ju dëbon drejtë për së drejti në vendlindjen e juaj, pa e shqyrtuar mirë kërkesën e juaj të azilit ndonëse ju e plotësoni besueshmërinë e statusit të refugjatëve.

Madje edhe nëse ju do të dëboheni në shtetin përgjegjës evropian, do të vendoset për ankesën e juaj këtu në Zvicër. E lajmëroni gjykatën federale administrative (shikoni adresën e mëposhtme) se në cilin shtet do duhej dërguar ky vendim.

Në qoftë se keni ndonjë përfaqësues ligjor, ju lutëm ti mbani kontaktet edhe nëse gjendeni jashtë vendit. Vetëm në këtë mënyrë mund ti pranoni vendimet e mundshme pozitive se ju mund të udhëtoni prapë për në Zvicër



5. Ankesa

Në qoftë se nuk jeni dakord me vendimin e azilit të Entit Federal për Migracion, mund t'i shkruani një ankesë Gjykatës Federale Administrative:

[Bundesverwaltungsgericht](#)

Postfach, CH-3000 Bern 14

Telefon +41 (0)58 705 26 26

Faks +41 (0)58 705 29 80

Në fund të vendimit të azilit është shkruar se **sa ditë keni kohë** në qoftë se dëshironi të bëni ankesë (nën paragrafin “**Sqarim për mjete ankesë (Rechtsmittelbelehrung / Voies de droit)**” – 5 ditë ose 30 ditë).

Qendra për këshillim ligjor ose avokatë (përkatësisht avokate) mund t'ju ndihmojnë (shih listën e adresave ose në <http://www.for-refugees.ch>). Përveç kësaj, SFH-ja ju jep në dispozicion një udhëzues për ankesë (<http://www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe/informationsblaetter>).

Adresat e qendrave për këshillim ligjor pranë qendrave të pritjes

Basel

Freiburgerstrasse 66, 4057 Basel, Tel. 061 631 30 58.

Kreuzlingen

Bahnhofstr. 2, 8280 Kreuzlingen, Tel. 071 622 42 41.

Chiasso

SOS Antenna Profughi, Via Bossi 11, 6830 Chiasso, Tel. 091 682 67 85

Vallorbe

SAJE Service d'Aide juridique aux Exilés, Place de la Gare, 1337 Vallorbe, Tel. 021 843 21 25.

Adresat në **kantonet** shih:

www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe/nuetzliche-adressen

6. Informata të përgjithshme

Këshillim ligjor, avokat, avokate

Ju duhet të kujdeseni vetë për mbështetje juridike. Qendrat e këshillimit ligjor të shoqatave humanitare i gjeni në <http://www.for-refugees.ch/> ose në një listë të veçantë adresash.

Ardhja e mëpasshme e familjes, ribashkim familjar

Azilkërkuesit nuk kanë të drejtën të marrin më pas anëtarë të familjes nga vendlindja.

Asistencë, ndihmë urgjente

Azilkërkuesit nevojtarë marrin asistencë gjatë procedurës së azilit.

Kushtetuta e Zvicrës (neni 12) u siguron të gjithë njerëzve që jetojnë në Zvicër, ndihmë dhe kujdesie në situata emergjente. Pas një vendimi negativ të azilit, keni **të drejtën për ndihmë urgjente** deri në largimin tuaj, edhe pse jeni **ilegalisht** në Zvicër. Kjo ndihmë përfshin: **ushqim, strehim, veshmbathje dhe ndihmë mjekësore** në raste urgjente. Meqë për këtë ndihmë urgjente duhet të lajmëroheni tek autoritetet, të cilat janë përgjegjëse edhe për dëbimin e juaj nga Zvicra, kaloni rrezikun që të arrestoheni. Informata të mëtejshme i gjeni në <http://www.for-refugees.ch/>

Punë

Autoritetet zvicerane u ndalojnë azilkërkuesve punën gjatë tre deri gjashtë muajt e parë. Pastaj mund të lejohet një punësim, ku vetëm pak degë janë të hapura, dhe punëtorëve vendas u jepet përparësi.

Banim

Duhet t'i njoftoni autoritetet menjëherë për çdo ndërrim adrese. Në përgjithësi, një ndërrim kantoni nuk është i mundur për azilkërkuesit.

Arrestim, burgim

Mund të arrestoheni në qoftë se:

- kërkesa e juaj e azilit është refuzuar me një vendim të mospranueshmërisë.
- refuzoni të bashkëpunoni me autoritetet
- kërkesa juaj e azilit vlerësohet si "keqpërdorës".
- jeni bërë i penalizuar duke shkelur ligjin
- ka shenja konkrete se do t'i kundërshtoni dëbimit në vendlindjen tuaj.

Udhëtime jashtë shtetit

Nuk duhet të largoheni nga Zvicra gjatë procedurës së azilit dhe nuk duhet të hyni në kontakt me konsullatën ose me autoritetet e vendit nga keni ardhur.